



VENDIM

Nr. 637, datë 26.10.2018

PËR

DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE TE FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS DHE QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, TË VILAVE NR.5, NR. 6 DHE TË PALESTRËS TË BLOKUT TË VILAVE GJERMANE, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 e në vijim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim, pa shpërblim, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, të vilës nr.5, me oborret përkatëse, të bllokut të Vilave Gjermane, Tiranë, dhe të Qendrës së Botimeve për Diasporën të vilës nr.6 dhe objektit ndërmjet (palestra) me oborret përkatëse, të këtij blloku, për një afat të pacaktuar, me qëllim shfrytëzimin e tyre si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative.
2. Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i tjetërsojnë ato ose t’ua japin në përdorim të tretëve.
3. Shpenzimet operative i ngarkohen Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën.



4. Të drejtat dhe detyrimet e tjera do të përcaktohen në kontratën e huapërdorjes që do të lidhet ndërmjet palëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
5. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A